Zyra e Kryetarit | 02 Nr._____ /2026 | Dt.10.02.2026

FTESË PUBLIKE

Ftesë për zgjedhjen e anëtareve të rinj të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) të Komunës së Deçanit

Në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012 MPB – 03/2012 MAPL për Këshillat Komunal për Siguri në Bashkësi, ftohen komunitetet që të bëjnë propozimin e tyre për anëtarë të KKSB-së.
Komunitetet të cilat kanë të drejtë të propozojnë anëtarët e tyre sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012 MPB – 03/2012 MAPL për Këshillat Komunal për Siguri në Bashkësi, janë si vijon:

- Nga një përfaqësues legjitim secila bashkësi fetare në Komunën e Deçanit;
- Nga një përfaqësues secili komunitet etnik në Komunën e Deçanit;
- Një përfaqësues nga Organizatat e Shoqërisë Civile që veprojnë në Komunën e Deçanit (OJQ);
- Një përfaqësues nga komuniteti i Biznesit;
- Një përfaqësues nga komuniteti i personave me aftësi të kufizuara;

Anëtarët tjerë të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi caktohet në bazë të nenit 4 të Udhëzimet Administrative Nr. 27/2012 MPB – 03/2012 MAPL për Këshillat Komunal për Siguri në Bashkësi.
Propozimet mund të dorëzohen nga data 10.02.2026 deri me datë 23.02.2026 në zyrën e Informacionit kati i parë në Objektin e Komunës, Rruga "Jashar Salihaj" Nr.3 51000, Deçan ose në emalin: edone.kameraj@rks-gov.net

Vërejtje: Pas përfundimit të afatit të cekur me lartë nuk do të pranohen propozimet për anëtarë

Kryetari i Komunës së Deçanit
Bashkim Ramosaj